# DËSHMI ARKIVI

**A-449154**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Haga gëzoi dushmanin e Kosovës, Daçiç: UÇK-ja organizatë kriminale |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1392051.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 12:33:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 16 shtator 2026, 12:24:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 16 shtator 2026, 12:23:00 UTC → 16 shtator 2026, 12:25:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d66acf9ded53a16fbf58c671c344c957adfb7e06621e50a4f429f5ff387dcd9a` |
| TEKSTI | `008170cd50a7fda4e3cfcd7a8c6bf738af17234bead085433cce3f9867b26b2b` |
| PAMJA | `fd2dbd3f28f050312200311bf4bd58c57fb22855689da59a818ca5d00972666b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `40fb0e5c5644df4da35d4e72a1434fc46320b3b1328299bc64a5a93381e600fd` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/40fb0e5c5644df4da35d4e72a1434fc46320b3b1328299bc64a5a93381e600fd`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Haga gëzoi dushmanin e Kosovës, Daçiç: UÇK-ja organizatë kriminale

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 16.09.2026, 14:24

Share Share



Zëvendëskryeministri dhe ministri në detyrë i Punëve të Brendshme të Serbisë, Ivica Daçiç, ka reaguar pas aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, duke pretenduar se vendimi përbën, sipas tij, konfirmim të qëndrimeve të Serbisë për UÇK-në. Daçiç tha se aktgjykimi dëshmon, sipas pretendimit të tij, se UÇK-ja ishte "organizatë kriminale dhe terroriste" dhe se drejtuesit e saj politikë e ushtarakë mbanin përgjegjësi për krime të kryera gjatë luftës në Kosovë.

Megjithatë, Dhomat e Specializuara i kanë gjykuar katër të akuzuarit mbi bazën e përgjegjësisë së tyre penale individuale. Ata u shpallën fajtorë për krime lufte, ndërsa u liruan nga akuzat për krime kundër njerëzimit. Aktgjykimi, rrjedhimisht, nuk përbën një përcaktim gjyqësor se e gjithë UÇK-ja ishte organizatë kriminale apo terroriste.

Daçiç kritikoi veçanërisht rrëzimin e akuzave për krime kundër njerëzimit, duke e cilësuar atë si "manovër politike". Ai pretendoi se vendimi minimizon vuajtjet e viktimave serbe dhe shtoi se as dënimet e shqiptuara nuk janë të mjaftueshme për familjet e viktimave. Deklaratat e tij përfaqësojnë qëndrimin e zyrtarit serb dhe jo konstatime të gjykatës përtej asaj që përcaktohet në aktgjykim.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

## Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.